



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 19.09.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIN E GJENEVËS TË MARRËVESHJES SË LISBONËS PËR EMËRTIMET E ORIGINËS DHE TREGUESIT GJEOGRAFIKË”

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 19.09.2018 shqyrtoi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Prezantimi i projektligjit

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, znj. Albana Shkurta, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, z. Elvin Lako, drejtor i Përgjithshëm, Znj. Rudina Bollano, drejtor dhe znj. Rudina Meneri, përgjegjës sektori.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji synon aderimin e Shqipërisë në aktin e Gjenevës, i cili mundëson regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës dhe lejon hyrjen në marrëveshjen e Lisbonës të organizatave ndërqeveritare.

Ky akt i siguron palëve kontraktuese mbrojtje mbi emërtimet e regjistruara të origjinës dhe treguesit gjeografik në territorin e tyre, brenda sistemit ligjor dhe praktikës së tyre, por në përputhje me kushtet e këtij akti. Përmes këtij projektligji favorizohen si aplikantët vendas, të cilët përmes një aplikimi mund të sigurojnë mbrojtje ndërkombëtare në të gjitha vendet anëtare të këtij akti, por edhe ata të huaj, të cilëve u jepet një siguri më e madhe për ushtrimin e biznesit të tyre.

Duke qenë se treguesit gjeografikë ose emërtimet e origjinës janë produkte, të cilat paraqesin rëndësi të veçantë për Shqipërinë, regjistrimi kombëtar, si dhe ai ndërkombëtar ndikojnë në rritjen e vlerës të këtyre produkteve tradicionale, gjallërojnë zonat ruralë, ruajnë biodiversitetin, trashëgiminë kulturore dhe gastronomike dhe siguron paraqitjen e produkteve karakteristike shqiptar në tregjet e huaja.

Si paraqitet dhe në relacionin shpjegues, ky akt sjell përparësi dhe ndryshime në sigurimin e së drejtës për mbrojtjen e markave dhe treguesve gjeografikë, si dhe siguron mjetet ligjore për parandalimin e përdorimit të paautorizuar të këtyre treguesve gjeografikë

Efektet financiare

Efektet financiare që parashikohen janë vetëm tarifat e regjistrimit dhe aplikimit, të cilat parashikon në marrëveshje për secilin shtet kontraktues.

Diskutimet në Komision :

Deputetët në komision u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjeve dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive. Pati diskutime në lidhje me kufizimet apo mbrojtjen që parashikohet në rast të abuzimeve me të drejtën e markës, si dhe u sqarua koncepti i mbrojtjes nëpërmjet regjistrimit. Gjithashtu u diskutuan format e promovimit dhe informimit të qytetarëve mbi mbrojtjen e treguesve gjeografikë. Pas sqarimeve nga përfaqësuesit e ministrisë komisioni votoi dhe miratoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI